



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

(Draft 3, Version 1 datë 22.04.2014)

Nr. _____, datë _____

“MBI MASAT PËR KUFIZIMIN E SHKARKIMIT TË PËRBËRSVE ORGANIKË TË AVULLUESHËM NGA PËRDORIMI I TRETËSVE ORGANIKË NË DISA VEPRIMTARI DHE INSTALIME”*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 14, pikës “a” të draftit 3, versioni 3 i Ligjit nr._____, datë ____ “Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër”, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të parandalojë ose pakësojë efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të shkarkimeve të përbërsve organikë të avullueshëm në mjedis, kryesisht në ajër, dhe rreziqet potenciale në shëndetin e njeriut, duke parashikuar masa dhe procedura për t’u zbatuar për disa veprimtari.
2. Ky vendim mbulon veprimtaritë e përcaktuara në Aneksin I, për aq kohë sa ata funksionojnë mbi pragjet e konsumimit të tretësve të listuar në Aneksin IIA.

II. PËRKUFIZIME

3. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a. “AKM” është Agjensia Kombëtare e Mjedisit sipas përcaktimit të Ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
 - b. “ARM” janë Agjensitë Rajonale të Mjedisit sipas përcaktimit të Ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
 - c. “bojë” është një përzierje, përfshirë të gjithë tretësit organikë ose përzierjet me përmbajtje tretësish organikë që nevojiten për përshtatjen e përdorimit të tyre, e cila

* Ky vendim përafrohet:

1. Direktivën 1999/13/EC “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërsve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime” të ndryshuar nga Rregullorja 1882/2003, Directiva 2004/42/CE dhe Direktiva 2008/112/EC (Fletorja Zyrtare L 085, 29/03/1999 fq. 0001 – 0022).
2. Vendimin e Komisionit 2000/541/EC “Mbi kriteret për vlerësimin e planeve kombëtare sipas Nenit 6 të Direktivës 1999/13/EC (Fletorja Zyrtare L 230/16, 12.9.2000)

- përdoret në veprimtari printimi për të printuar tekste ose stampuar imazhe në një sipërfaqe të caktuar;
- c. **“funksionim normal”** janë të gjitha periudhat e funksionimit të instalimit ose veprimtarisë me përjashtim të funksioneve të ndezjes, ndalimit dhe mirëmbajtjes së pajisjes;
 - d. **“funksionet e ndezjes dhe fikjes”** janë operacionet që aktivizojnë apo ç’aktivizojnë një veprimtari, pajisje ose çisternë apo e fusin apo nxjerrin atë nga një regjim pune pa ngarkesë. Fazat e luhatjeve të rregullta të veprimtarisë nuk konsiderohen si ndezje dhe fikje;
 - dh. **“instalim”** është njësia teknike e palëvizshme, në të cilën kryhen një ose më shumë nga veprimtaritë e mbuluara nga objekti i përcaktuar në paragrafin 2 të Kreut I dhe çdo lloj veprimtarie tjetër që lidhet drejtpërdrejt me të, që ka lidhje teknike me veprimtaritë e kryera në atë vend, të cilat mund të kenë ndikim mbi shkarkimet;
 - e. **“instalim ekzistues”** është instalimi që është në funksionim ose instalimi për të cilin është lëshuar një leje mjedisi e Tipit A sipas legjislacionit ekzistues përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me kusht që instalimi të jetë vënë në funksionim jo më vonë se një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
 - ë. **“instalim i vogël”** është instalimi që bie në pragun më të ulët të grupit të artikujve 1, 3, 4, 5, 8, 10, 13, 16 ose 17 të Aneksit IIA ose për veprimtari të tjera të Aneksit IIA që konsumojnë tretës më pak se 10 ton/në vit;
 - f. **“input”** është sasia e tretësve organikë dhe sasia e tyre në përzierjet e përdorura gjatë kryerjes së një veprimtarie, përfshirë tretësit e ricikluar brenda dhe jashtë instalimit, të cilat llogariten çdo herë që ato përdoren për kryerjen e veprimtarisë;
 - g. **“ISHMPU”** është Inspektoriati Shtetëror për Mjedisin, Pyjet dhe Ujërat sipas përcaktimit të Vendimit nr.46, datë 29.1.2014 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”;
 - gj. **“konsum”** është inputi total i tretësve organikë në një instalim gjatë një viti kalendarik ose gjatë çdo periudhe tjetër 12 mujore, minus VOC që është rikuperuar/ rigjeneruar për ripërdorim;
 - h. **“kapaciteti nominal”** është inputi maksimal hyrës nga një instalim i tretësve organikë, i mesatarizuar për një ditë, në qoftë se instalimi funksionon sipas kushteve normale të funksionimit të projektuara për të;
 - i. **“kushtet e mbajtjes”** janë kushtet në të cilat instalimi funksionon në mënyrë të tillë që VOC e çliruara nga veprimtaria mblidhen dhe shkarkohen në mënyrë të kontrolluar nëpërmjet një oxhaku ose pajisje për pakësimin e shkarkimeve dhe si pasojë janë jo tërësisht fluruese;
 - j. **“kushtet standarde”** janë temperatura 273,15 K dhe trysnia 101,3 kPa;
 - k. **“Kategoritë M1-M3, N1-N3, O1-O3”** kanë të njëjtin kuptim si në Udhëzimin nr.11, datë 6.6.2011 “Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike të destinuara për këto mjete”;
 - l. **“Leje mjedisi e Tipit A, B ose C”** ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”;
 - ll. **“llak”** është një veshje transparente;
 - m. **“mbetje e gaztë”** është shkarkimi i gaztë përfundimtar nga oxhaku ose pajisja për pakësimin e shkarkimeve në ajër që përmban përbërës organikë të avullueshëm ose ndotës të tjerë. Normat vëllimore të prurjes shprehen në m³/orë në kushte standarde;
 - n. **“masa e rrjedhjes”** është sasia e VOC të çliruar dhe matet në njësinë masë/orë;
 - nj. **“mesatarja e 24 orëve”** është mesatarja aritmetike e të gjitha leximeve të vlefshme të marra gjatë periudhës 24 orëshe të funksionimit normal;
 - o. **“Ministër”** është ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit;
 - p. **“ministra”** është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
 - q. **“ndryshim i konsiderueshëm”**:

- i. për instalimin që është objekt i lejeve të mjedisit të Tipit A, sipas Ligjit nr.10448 datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, ka të njëjtin kuptim si në këtë ligj;
- ii. për instalimin e vogël, është një ndryshim i kapacitetit nominal që çon në rritje të shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm më shumë se 25%. Çdo ndryshim që sipas vlerësimit të AKM, mund të ketë efekte negative të konsiderueshme mbi shëndetin e njeriut ose mjedisin është gjithashtu një ndryshim i konsiderueshëm;
- iii. për të gjitha instalimet e tjera, është një ndryshim i kapacitetit nominal që çon në rritjen e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm më shumë se 10%. Çdo ndryshim që mund të ketë, sipas vlerësimit të AKM, efekte negative të konsiderueshme mbi shëndetin e njeriut ose mjedisin është gjithashtu një ndryshim i konsiderueshëm;
- r. **“ngjitës”** është çdo përzierje, përfshirë të gjithë tretësit organikë ose përzierjet me përmbajtje tretësish organikë të nevojshëm për aplikimin e tyre sic duhet, i cili përdoret për ngjitjen e pjesëve të veçanta të produktit;
- rr. **“Operator”** ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”;
- s. **“përzierje”** janë përzierjet ose solucionet e përbërë nga dy ose më shumë substanca;
- sh. **“përbërës organik”** është çdo përbërës që përmban të paktën elementin karbon dhe një ose më shumë elementë hidrogjeni, halogjeni, oksigjeni, squfuri, fosfori, silici ose azoti, me përjashtim të oksideve të karbonit, karbonateve inorganike dhe bikarbonateve;
- t. **“përbërës organik i avullueshëm (VOC)”** është çdo përbërës organik që në 293,15 K ka një trysni avulli prej 0,01 kPa ose më shumë ose që në kushte të veçanta përdorimi ka avullueshmëri të ngjashme. Për qëllime të këtij vendimi, fraksioni i katranit që kalon vlerën e trysniit të avullit prej 293,15 K konsiderohet si VOC;
- th. **“QKL”** është Qendra Kombëtare të Liçensimit sipas përcaktimit në ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- u. **“regjistrim”** është regjistrimi nga AKM ose ARM, sipas rastit, i instalimit ose veprimtarisë që synohet të vihet në funksionim, që është objekt i këtij vendimi dhe është njoftuar nga operatori;
- v. **“ripërdorimi i tretësve organikë”** është përdorimi i tretësve organikë të rigjeneruar nga instalimi për qëllime tregtare ose teknike dhe përfshin përdorimin si karburant, por përjashton zhvendosjen përfundimtare të tretësve organikë të tillë të rigjeneruar si mbetje;
- x. **“substancë”** është çdo element kimik dhe përbërësi i tij, në gjëndjen e tyre natyrale ose sic janë prodhuar nga industria, qoftë kjo në formë të ngurtë, të lëngët ose të gaztë;
- xh. **“Shkarkim”** është çdo clirim i përbërësve organikë të avullueshëm nga instalimi në mjedis;
- y. **“Shkarkim flurues”** është çdo shkarkim i përbërësve organikë të avullueshëm në ajër që nuk bëhet përmes mbetjeve të gazta në ajër, tokë dhe ujë, po qe se nuk është përcaktuar ndryshe në Aneksin IIA, tretësit që përmban çdo produkt. Ato përfshijnë shkarkimet e pakapura të lëshuara në mjedisin e jashtëm nëpërmjet dritareve, dyerve, erërave dhe hapjeve të ngjashme;
- z. **“Shkarkimi total”** është shuma e shkarkimeve fluruese me shkarkimet në mbetje të gazta;
- zh. **“Vlera kufi e shkarkimit”** është masa e përbërësve organikë të avullueshëm e shprehur në terma të disa parametrave specifike, përqëndrim, përqindje dhe/ose nivel i shkarkimit të llogaritur në kushte standarde, N, që nuk mund të kalojë gjatë një ose më shumë periudhave kohore;
- aa. **“tretës organik”** është çdo VOC që përdoret vetëm ose në kombinim me agjentë të tjerë dhe pa pësuar ndonjë ndryshim kimik, për të tretur lëndë të para, produkte ose materiale mbetje apo si agjent pastrimi për të tretur ndotës, ose si tretës, si mjet hollues, si rregullues i viskozitetit, si rregullues i tensionit sipërfaqësor, si plastifikues apo si prezervativ;
- bb. **“tretës organik i halogjenizuar”** është tretësi organik që përmban të paktën një atom bromi, klori, fluori ose jodi për molekulë;

- cc. “veshje” është çdo përzierje, përfshirë të gjithë tretësit organikë ose përzierjet që përmbajnë tretës organikë të nevojshëm për aplikimin e tyre sic duhet, e cila përdoret për të dhënë efekte dekorative, mbrojtëse ose efekte të tjera funksionale mbi një sipërfaqe të caktuar;

III. DETYRIMET QË ZBATOHEN PËR INSTALIMET E REJA

4. Operatorët marrin masat e nevojshme që:
 - a. instalimet e reja të përputhen me dispozitat e parashikuara në Kreun V, VIII dhe IX të këtij vendimi;
 - b. instalimet e reja të Tipit B dhe C të regjistrohen në AKM dhe ARM përkatësisht ose të pajisen me lejen përkatëse të mjedisit të tipit B ose C për të funksionuar, përpara vënies së tyre në funksionim.

IV. DETYRIMET QË ZBATOHEN PËR INSTALIMET EKZISTUESE

5. Pa rënë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionet të posaçëm për lejet e mjedisit të Tipit A, operatorët duhet të sigurojnë që instalimet ekzistuese:
 - a. të jenë në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun V, VIII dhe IX të këtij vendimi jo më vonë se 31 Tetor 2024;
 - b. të regjistrohen ose të pajisen me leje mjedisi për të funksionuar jo më vonë se 31 Tetor 2024;
6. Operatorët e këtyre instalimeve që do të kërkojnë leje apo do të regjistrohen sipas skemës së pakësimit të shkarkimeve të parashikuar në Aneksin IIB duhet të njoftojnë për këtë AKM jo më vonë se 31 Tetor 2022 ;
7. Kur instalimi:
 - a. i nënshtrohet një ndryshimi të konsiderueshëm, ose
 - b. bëhet objekt i këtij vendimi për herë të parë, si pasojë e ndryshimit të konsiderueshëm, kjo pjesë e instalimit, e cila i nënshtrohet ndryshimit të konsiderueshëm trajtohet si një instalim i ri. Ajo mund të trajtohet edhe si një instalim ekzistues, por vetëm me kushtin që shkarkimet totale të të gjithë instalimit të mos i kapërcejnë shkarkimet që mund të rezultojnë, në qoftë se pjesa e ndryshuar konsiderueshëm do të ishte trajtuar si instalim i ri.

V. KËRKESAT

8. AKM ose ARM sipas rastit:
 - a. krijon dhe mban regjistrin e instalimeve ose veprimtarive që janë objekt i këtij vendimi dhe janë njoftuar nga operatorët përkatës;
 - b. përcakton në kushtet e lejeve të mjedisit kërkesa specifike që sigurojnë që instalimet të përputhen me dispozitat e paragrafëve 9 deri 20 të këtij Kreu.
9. Të gjitha instalimet duhet të jenë në përputhje me:
 - a. vlerat kufi të shkarkimit në mbetjet e gazta dhe vlerat e shkarkimeve fluruese ose vlerat kufi të shkarkimit total dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në Aneksin IIA; ose
 - b. kërkesat e skemës së pakësimit të shkarkimeve të përcaktuara në Aneksin IIB.
10. a. Për shkarkimet fluruese, AKM ose ARM sipas rastit, si vlerë shkarkimi kufi në instalime zbaton vlerat e shkarkimeve fluruese. Megjithatë, kur operatori është në gjendje të demonstrojë dhe bindë AKM ose ARM se për një instalim të caktuar kjo vlerë nuk është e mundur të arrihet teknikisht dhe ekonomikisht, AKM ose ARM mund të bëjë një përjashtim për një instalim të tillë me kusht që prej tij të mos priten rreziqe të konsiderueshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Për çdo përjashtim, operatori duhet të demonstrojë dhe të bindë AKM ose ARM se përdor teknikën më të mirë të disponueshme;
- b. Veprimtaritë që nuk mund të funksionojnë në kushtet e mbajtjes mund të përjashtohen nga kontrollet e parashikuara në Aneksin IIA, kur kjo mundësi është përmendur qartësisht në këtë Aneks. Më pas, po qe se nuk demonstrohet dhe bindet AKM ose ARM që ky variant nuk është teknikisht dhe ekonomikisht i realizueshëm, duhet të përdoret skema e pakësimit të shkarkimeve e parashikuar në Aneksin IIB. Në këtë rast, operatori duhet të demonstrojë dhe bindë AKM se po përdor teknikën më të mirë të disponueshme.
- c. AKM në përputhje me kreun XI i raporton Ministrisë për përjashtimet në lidhje me

- shkronjat “a” dhe “b” të këtij paragrafi.
11. Për instalimet që nuk përdorin skemën e pakësimit të shkarkimeve, çdo pajisje e pakësimit të shkarkimeve e instaluar pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e parashikuara në Aneksin IIA.
 12. Instalimet ku kryhen dy ose më shumë veprimtari, ku secila kalon pragjet e përcaktuara në Aneksin IIA:
 - a. kërkesat për substancat e përcaktuara në paragrafët 13, 14 dhe 15 më poshtë do t'i plotësojnë individualisht për secilën veprimtari ;
 - b. kërkesat lidhur me të gjitha substancat e tjera të paragrafit 9, do t'i
 - i. plotësojnë individualisht për secilën veprimtari; ose
 - ii. shkarkimet totale nuk i kalojnë shkarkimet që mund të rezultojnë po që se zbatohet paragrafi “i”.
 13. Substancat ose përzierjet të cilat për shkak të përmbajtjes së VOC në legjislacionin e posaçëm për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave dhe përzierjeve të rrezikshme klasifikohen si kancerogjene, mutagjene ose toksike për riprodhimin kanë marrë apo kanë të nevojshme të mbajnë kodet e rrezikut R45, R46, R49, R60, R61, do të zëvendësohen sa më shumë të jetë e mundur dhe duke marrë parasysh udhëzimin e referuar në paragrafin 35, të Kreut VII nga substanca ose përzierje më pak të dëmshme brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.
 14. Për shkarkimet e VOC të referuara në paragrafin 13 më sipër, kur masa e prurjes së shumës së përbërësve që çon në kodet e rrezikut të referuara në paragrafin 13 është më e madhe ose e barabartë me 10 g/orë, zbatohet vlera kufi e shkarkimit prej 2 mg/Nm³. Vlera kufi e shkarkimit i referohet shumës së masës së përbërësve të vecantë.
 15. Për shkarkimet e VOC të halogjenizuara për të cilat janë caktuar kodet e rrezikut R40 ose R68, kur masa e rrjedhjes së shumës të përbërësve, që çon në kodet R40 ose R68, është më e madhe ose e barabartë me 100 g/orë, zbatohet vlera kufi e shkarkimit prej 20 mg/Nm³. Vlera kufi e shkarkimit i referohet masës së shumës të përbërësve të vecantë.
 16. Me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit shkarkimi i VOC të referuar në paragrafët 13 dhe 15 më sipër, për aq sa është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, do të kontrollohet si shkarkim nga instalimi në kushte mbajtjeje.
 17. Shkarkimet e VOC të cilave, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, u është caktuar ose duhet të mbajnë një nga kodet e rrezikut të referuara në paragrafin 13 dhe 15 më sipër, brenda një kohe sa më të shkurtër duhet të përputhen me vlerat kufi të shkarkimit të referura respektivisht në paragrafin 14 dhe 15.
 18. Për të minimizuar shkarkimet gjatë ndezjes dhe fikjes merren të gjitha masat paraprake të përshtatshme.
 19. Instalimet ekzistuese të cilët përdorin pajisje për pakësimin e shkarkimeve dhe përputhen me vlerat kufi të shkarkimit të mëposhtme:
 - a. 50 mg C/Nm³ në rastin e incinerimit;
 - b. 150 mg C/Nm³ në rastin e çdo pajisje tjetër për pakësimin e shkarkimeve;
 do të përjashtohen nga vlerat kufi të shkarkimit të mbetjeve të gazta të përcaktuara në tabelën e dhënë në Aneksin IIA për një periudhë 12 vjeçare pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me kusht që shkarkimet totale të të gjithë instalimit të mos kalojnë shkarkimet që mund të rezultojnë nga plotësimi i të gjitha kërkesave të tabelës.
 20. Instalimet që shkarkojnë substancat e përcaktuara në paragrafin 13, 14 dhe 15 më sipër nuk përjashtohen nga plotësimi i kërkesave të parashikuara në këta paragrafë edhe kur zbatohet skema e pakësimit të shkarkimeve, paragrafi 19 më sipër apo Kreu VI më poshtë.

VI. PLANET KOMBËTARE PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE TË VOC

21. Ministria, pa rënë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të posaçëm për lejet e mjedisit për veprimtaritë e Tipit A, mund të hartojë plane kombëtare për pakësimin e shkarkimeve të VOC nga veprimtaritë dhe instalimet industriale e mbuluara nga Kreu I i këtij vendimi.
22. AKM ka detyrë të mbledhë dhe vlerësojë informacionin e kërkuar në paragrafin 29, dhe të

- zbatojë planin kombëtar.
23. Ministria mund të përjashtojë vetëm veprimtaritë 4 dhe 11 të Aneksit IIA nga plane të tilla, por asnjë nga veprimtaritë e tjera nuk mund të përjashtohet nga fusha e zbatimit të këtij Vendimi nëpërmjet një plani kombëtar.
 24. Ministria gjatë hartimit të planeve kombëtare mund të përjashtojë instalimet ekzistuese nga zbatimi i vlerave kufi të shkarkimit të përcaktuara në paragrafin 9 dhe 10 të Kreut V dhe Aneksit II.
 25. Plani kombëtar në asnjë rrethanë nuk mund të përjashtojë një instalim ekzistues nga zbatimi i dispozitave të parashikuara për veprimtaritë e Tipit A në legjislacionin e posaçëm për lejet e mjedisit.
 26. Instalimet ekzistuese që i nënshtrohen një ndryshimi të konsiderueshëm do të vazhdojnë të jenë objekt i planit kombëtar, me kusht që ata të kenë qënë pjesë e këtij plani përpara se t'i nënshtroheshin një ndryshimi të tillë të konsiderueshëm.
 27. Plani kombëtar duhet të rezultojë me një pakësim të shkarkimeve vjetore të VOC nga instalimet ekzistuese të mbuluara nga ky vendim, të paktën me të njëjtën sasi dhe brenda të njëjtit afat kohor, që mund të arrihej duke zbatuar kufijtë e shkarkimit sipas paragrafëve 9 dhe 10 të Kreut V dhe Aneksit II, gjatë periudhës së vlefshmërisë të planit kombëtar.
 28. Plani kombëtar:
 - a. përfshin:
 - i. identifikimin e veprimtarisë ose veprimtarive për të cilat zbatohet plani;
 - ii. listën e masave të marra ose që do të merren për të siguruar arritjen e qëllimit të përcaktuar në paragrafin 21;
 - iii. pakësimin e shkarkimeve që duhen arritur nga këto veprimtari që i korespondojnë asaj që do të arrihej nga zbatimi i kufijve të shkarkimit të përcaktuar në Aneksin IIA;
 - iv. objektivat e ndërmjetëm, të detyrueshëm të pakësimit të shkarkimeve, ndaj të cilave mund të matet progresi në drejtim të arritjes së qëllimit;
 - v. numrin e instalimeve të prekura nga plani dhe shkarkimet totale të tyre, si dhe shkarkimin total të secilës veprimtari;
 - vi. përshkrimin e plotë të gamës së instrumenteve nëpërmjet të cilave do të plotësohen kërkesat e tij;
 - vii. të dhëna që këto instrumente do të jenë të zbatueshëm;
 - viii. detajet e mjeteve me anë të të cilave demonstron përputhshmëria me planin;
 - ix. detajet e mekanizmit të monitorimit të planit të propozuar;
 - b. duhet të jetë në përputhje me legjislacionin ekzistues përkatës dhe dispozitat përkatëse të këtij Vendimi.
 29. Plani shoqërohet me dokumentacion mbështetës të mjaftueshëm për të verifikuar arritjen e qëllimit të përcaktuar në paragrafin 21.
 30. Planet kombëtare miratohen pas konsultimeve me ministrinë e linjës, aktorë të tjerë dhe publikun.
 31. Ministrinë e linjës brenda 1 muaji dërgojnë komentet mbi planet kombëtare për pakësimin e shkarkimeve të VOC nga veprimtaritë dhe instalimet industriale.
 32. Plani kombëtar rishikohet dhe, në qoftë se është e nevojshme, përditësohet çdo 3 vjet.
 33. Kriteret për vlerësimin e planeve kombëtare janë përcaktuar në Aneksin IV.
 34. ISHMPU monitoron zbatimin e planit nga instalimet përkatëse të mbuluara nga ky plan.

VII. ZËVENDËSIMI

35. Për çdo veprimtari Ministri miraton udhëzimin mbi përdorimin e substancave dhe teknikat të cilat kanë efektet potenciale më të pakta në ajër, ujë, tokë, ekosisteme dhe shëndetin e njeriut.
36. AKM siguron se udhëzimi i referuar në paragrafin më sipër merret parasysh gjatë përcaktimit të kushteve për lejet e mjedisit.

VIII. MONITORIMI

37. Operatori i instalimit të mbuluar nga ky vendim dërgon një herë në vit në ISHMPU ose me

kërkesë të tij, të dhënat që i nevojiten ISHMPU dhe ministrisë për të verifikuar përputhshmërinë me këtë vendim.

38. Operatori do të:

- a. vetëmonitorojë vazhdimisht përputhshmërinë në qoftë se kanalet me të cilat është lidhur pajisja e pakësimit të shkarkimeve, dhe të cilat në pikën fundore të shkarkimit shkarkojnë më shumë se mesatarja prej 10 kg/orë karbon organik total;
- b. kryejë matje të vazhdueshme ose periodike në raste të tjera. Për matjet periodike merr të paktën tre lexime gjatë çdo matje.
- c. përjashtohet nga kërkesa për të bërë matje kur pajisja e pakësimit të shkarkimeve në fund të procesit nuk ka nevojë të plotësojë kërkesat e këtij vendimi.

IX. PËRPUTHSHMËRIA ME VLERAT KUFIT TË SHKARKIMIT

39. Operatori i demonstroi ISHMPU përputhshmërinë me:

- a. vlerat kufi të shkarkimit në mbetjet e gazta, vlerat e shkarkimit fluruese dhe vlerat kufi të shkarkimit total;
- b. kërkesat e skemës së pakësimit të shkarkimeve sipas Aneksit IIB;
- c. dispozitat e parashikuara në paragrafin 10 të Kreut V.

40. Aneksi III jep udhëzime për planet e menaxhimit të tretësve që shërbejnë për të demonstruar përputhshmërinë me këto parametra.

41. Vëllime gazi mund të shtohen mbetjeve të gazta për qëllime ftohje ose hollimi kur një gjë e tillë justifikohet teknikisht, por nuk do të merret në konsideratë gjatë përcaktimit të përqëndrimit të masës së ndotësve në mbetjet e gazta.

42. ISHMPU riverifikon përputhshmërinë në vijim të një ndryshimi të konsiderueshëm.

43. Në rastin e matjeve të vazhdueshme do të konsiderohet që ato janë në përputhje me vlerat kufi të shkarkimit, në qoftë se:

- a. asnjë nga mesataret e 24 orëve të funksionimit normal nuk i kalon vlerat kufi të shkarkimit, dhe
- b. asnjë nga mesataret orare nuk i kalojnë vlerat kufi të shkarkimit me një faktor më të lartë se 1,5.

44. Në rastin e matjeve periodike do të konsiderohet se ato përputhen me vlerat kufi të shkarkimit, në qoftë se gjatë kryerjes së një monitorimi:

- a. mesatarja e të gjitha leximeve nuk i kalon vlerat kufi të shkarkimit, dhe
- b. asnjë nga mesataret orare nuk e kalon vlerën kufi të shkarkimit me një faktor më të lartë se 1,5.

45. Përputhshmëria me dispozitat e parashikuara në paragrafin 14, 15 dhe 16 të Kreut V verifikohet në bazë të shumës së përqëndrimeve të masës së secilit përbërës organik të avullueshëm në fjalë. Në të gjitha rastet e tjera, përveçse kur është parashikuar ndryshe në Aneksin IIA, përputhshmëria do të verifikohet në bazë të masës totale të karbonit organik të shkarkuar.

X. MOSPËRPUTHSHMËRIA

46. ISHMPU ose vetë operatori kanë detyrë të informojnë AKM kurdo që konstatojnë se kërkesat e këtij vendimi janë shkelur.

47. Operatori merr masa për të siguruar që përputhshmëria të arrihet brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

48. ISHMPU, në rast mospërputhshmërie që shkakton rrezik të menjëhershëm në shëndetin e njeriut dhe për sa kohë përputhshmëria nuk është arritur nën kushtet e parashikuara në paragrafin më sipër, pezullon funksionimin e veprimtarisë.

XI. SISTEMI I INFORMACIONIT DHE RAPORTIMI

49. Ministria përgatit çdo 3 vjet raportin për zbatimin e këtij vendimi. Raporti i parë mbulon periudhën e 3 viteve të para pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

50. Ministri miraton me Urdhër formatin e raportit të referuar në paragrafin 49.

51. Informacioni i paraqitur në raportin e referuar në paragrafin 49 përfshin veçanërisht të dhëna përfaqësuese të mjaftueshme për të demonstruar se kërkesat e parashikuara në Kreun V dhe sipas rastit, kërkesat e parashikuara në Kreun VI janë plotësuar.
52. Raporti përgatitet dhe publikohet në faqen elektronike të ministrisë brenda 9 muajve pas përfundimit të periudhës 3-vjeçare që ai mbulon.
53. Publikimi i këtij raporti i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në legjislacionin e posaçëm për të drejtën e publikut për të marrë informacion mjedisor.

XII. E DREJTA E PUBLIKUT PËR TË MARRË INFORMACION

54. AKM, pa rënë në kundërshtim me legjislacionin e posaçëm mbi të drejtën e publikut për të marrë informacion mjedisor, bën të disponueshëm për publikun:
 - a. të paktën kërkesat për leje mjedisi të Tipit A për instalimet e reja ose për ndryshimet e konsiderueshme të këtyre instalimeve;
 - b. legjislacionin e posaçëm të zbatueshëm për instalimet;
 - c. listën e veprimtarive të regjistruara dhe lejuara.
 - d. Rezultatet e monitorimit të shkarkimeve të kërkuar sipas lejes së mjedisit të Tipit A ose kushteve të regjistrimit të referuar në Kreun VIII dhe IX të këtij vendimi.
55. AKM, përpara përcaktimit të kushteve të lejes, i jep publikut 1 muaj kohë të paraqesë komentet e tij për kërkesa të tilla.
56. Kërkuesi, pa rënë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të posaçëm për lejet e mjedisit, për veprimtaritë e Tipit A nuk është i detyruar të riformatojë informacionin që jepet në kërkesën për leje për nevoja të publikut.
57. AKM, pas lëshimit të lejes së mjedisit nga QKL, bën të disponueshëm për publikun lejen e mjedisit të Tipit A dhe çdo përditësim vijues.
58. Paragrafi 54 zbatohet, në përputhje me legjislacionin e posaçëm për të drejtën e publikut për të marrë informacion për mjedisin, si dhe duke ruajtur të drejtën e konfidencialitetit të të dhënave tregtare dhe industriale.

XIII. AUTORITETET KOMPETENTE

59. Ministria, AKM, ARM dhe ISHMPU janë autoritetet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.

XIV. DISPOZITAT E FUNDIT

60. Ministri miraton aktet në zbatim të paragrafëve 35 dhe 50 të këtij vendimi.

XV. HYRJA NË FUQI

Ky vendim hyn në fuqi 5 vjet pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ANEKSI I OBJEKTI

Ky Aneks përmban kategoritë e veprimtarive të referuara në paragrafin 1 të këtij vendimi. Veprimtaritë e referuara në këtë Aneks, janë objekti i këtij vendimi kur funksionojnë mbi pragjet e listuara në Aneksin IIA. Në çdo rast, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe, veprimtaria përfshin pastrimin e pajisjes por jo pastrimin e produkteve.

Veshje me adeziv/me ngjitje

— Çdo veprimtari në të cilën një adeziv aplikohet mbi një sipërfaqe, me përjashtim të veshjeve ngjitëse dhe laminimit të shoqëruar me veprimtari printimi.

Veprimtari lyerje/veshje

— Çdo veprimtari në të cilën një aplikim i vetëm ose i shumëfishtë i një shtrese të hollë të pandërprerë aplikohet si veshje në:

- a. automjetet e listuara si më poshtë:
 - i. Makinat e reja, të përcaktuara si mjete të kategorisë M1 dhe të kategorisë N1 për sa kohë që ato janë lyer në të njëjtin instalim si mjete të kategorisë M1;
 - ii. Kabinën e kamionit, e përcaktuar si vendqëndrimi i shoferit dhe të gjitha pjesët ku vendosen pajisjet teknike të automjeteve të kategorisë N2 dhe N3,
 - iii. furgonë dhe kamionë, të përcaktuar si automjete të kategorisë N1, N2 dhe N3, por pa përfshirë kabinën e kamionit;
 - iv. autobusët, të përcaktuar si mjete të kategorisë M2 dhe M3;
- b. rimorkiot, të përcaktuara në kategoritë O1, O2, O3 dhe O4;
- c. sipërfaqet metalike dhe plastike përfshirë sipërfaqet e avionëve, anijeve, trenave, etj;
- d. sipërfaqet e drurit;
- e. sipërfaqet e tekstilit, pëlhurës, filmit dhe letrës;
- f. lëkurë.

Nuk përfshin lyerjen e nënshtresës me metale nga teknikat me spërkatje elektroforetike dhe kimike. Në qoftë se veprimtaria e lyerjes përfshin një hap në të cilin i njëjti produkt është printuar duke përdorur cilëndo lloj teknike, ai hap printimi konsiderohet si pjesë e veprimtarisë së lyerjes. Megjithatë, veprimtaritë printuese që funksionojnë si veprimtari të veçanta nuk janë përfshirë, por mund të mbulohen nga vendimi në qoftë se veprimtaria printuese bie në fushën e zbatimit të tij.

Lyerja/veshja e bobinave

— Çdo veprimtari ku spiralet/bobinat e çelikut, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i veshur, lidhjet e bakrit ose shiritat e aluminit janë veshur me një shtresë të hollë ose me laminat në një proces të pandërprerë.

Pastrimi kimik

— Çdo veprimtari industriale ose tregtare që përdor VOC në një instalim për të

pastruar veshjet, mobiljet dhe të mira të ngjashme konsumi me përjashtim të heqjes të njollave dhe pikave me dorë në industrinë tekstileve dhe të veshjeve.

Prodhimi i këpucëve

— Çdo veprimtari që prodhon këpucë ose pjesë të tyre.

Prodhimi i përzierjeve veshëse, llaqeve, bojërave dhe ngjitësve

— Prodhimi i produkteve përfundimtare të mësipërme dhe i produkteve të ndërmjetme kur kryhet në të njëjtin vend, duke përzier pigmente, rrëshirë dhe materiale ngjitëse me tretës organikë ose bartës të tjerë, përfshirë veprimtaritë e shpërndarjes dhe të para shpërndarjes, rregullimet e viskozitetit dhe të bojërave dhe operacionet për futjen e produktit përfundimtar në enën mbajtëse të tij.

Prodhimi i produkteve farmaceutike

— Sinteza kimike, fermentimi, ekstraktimi, formulimi dhe lustrimi i produkteve farmaceutike dhe produktet e ndërmjetëm kur prodhimi i këtyre të fundit kryhet në të njëjtin vend.

Printimi

— Çdo veprimtari që riprodhon tekst dhe/ose imazhe ku, me përdorimin e një bartësi të imazhit, boja transferohet në një sipërfaqe çfarëdo, përfshirë teknikat e llakimit, lysterjes/veshjes dhe laminimit që shoqërojnë atë. Megjithatë, vetëm nën proceset e mëposhtme janë objekt i këtij vendimi:

- a. Fleksografia — një veprimtari printimi që përdor një bartës imazhi prej gome ose fotopolimeri elastik mbi të cilën sipërfaqja që printohet ndodhet mbi sipërfaqen e që nuk printohet, duke përdorur bojë të lëngët, e cila thahet nëpërmjet avullimit;
- b. Tharja e shpejtë e bojës së stampimit/printimit me anë të ajrit të nxehtë — një veprimtari printuese web-fed duke përdorur një bartës imazhi në të cilën sipërfaqja e printuar dhe ajo e pa-printuar janë në të njëjtin plan, ku web-fed dmth që materiali për t'u printuar i vjen makinës nga një bobinë vecmas nga fletët e ndara. Sipërfaqja që nuk printohet trajtohet në mënyrë të tillë që të tërheqë ujin dhe të refuzojë bojën. Sipërfaqja që printohet trajtohet në mënyrë të tillë që të tërheqë dhe transmetojë bojën në sipërfaqen që do të printohet. Avullimi ndodh në një furrë ku për të nxehur dhe materialin e printuar përdoret ajrër i nxehtë;
- c. Laminimi që shoqëron veprimtarinë e printimit — ngjitjen së bashku të dy ose më shumë material flexible për të prodhuar laminate;
- d. Publikim rotogravurë — veprimtaria e printimit rotogravurë që përdoret për printimin e letrës për gazetatat, broshurat, katalogët ose produkte të ngjashme duke përdorur bojëra me bazë toluol;
- e. Rotogravurë — një veprimtari printimi që përdor një bartës imazhi cilindrik në të cilin sipërfaqja ku printohet është nën sipërfaqjen që nuk printohet, duke përdorur bojë të lëngët që thahet nëpërmjet avullimit. Gropëzat janë mbushur me bojë, teprica e të cilës hiqet nga sipërfaqja që nuk printohet përpara se sipërfaqja që do të printohet të kontaktojë me cilindrin dhe të thithë bojën nga gropëzat,
- f. Printimi me makinë shtypi rotative — një veprimtari printimi web-fed në të cilën

boja kalon sipërfaqen që do të printohet duke e detyruar atë nëpërmjet një bartësi imazhi poroz, në të cilin sipërfaqja që do të printohet hapet dhe sipërfaqja që nuk printohet vuloset, duke përdorur bojë të lëngët e cila thahet vetëm nëpërmjet avullimit. web-fed nënkupton që materiali që do të printohet i vjen makinës nga një bobinë vecmas nga fletët e ndara,

- g. lustrimi — një veprimtari nga e cila llaku ose veshja ngjitëse aplikohet mbi një material elastik me qëllim vulosjen e mëpasme të materialit ambalazhues.

Shndërrimi i gomës

— Çdo veprimtari përzierjeje, bluarje, trazimi, kalandrimi, nxjerrje/shtrydhje dhe vullkanizimi i gomës natyrale ose sintetike dhe çdo funksion ndihmës për shndërrimin e gomës natyrale ose sintetike në produkt përfundimtar.

Pastrimi i sipërfaqeve

— Çdo veprimtari me përjashtim të pastrimit të thatë që përdor tretës organikë për të hequr papastërtitë nga sipërfaqja e materialit përfshirë cgrasatimin apo heqjen e yndyrave. Veprimtaria e pastrimit që konsiston në më shumë se një hap përpara ose mbrapa çdo veprimtarie tjetër do të konsiderohet veprimtari pastrimi të sipërfaqes. Kjo veprimtari nuk i referohet pastrimit të pajisjes por pastrimit të sipërfaqes së produkteve.

Ekstraktimi i vajit vegjetal dhe yndyrës së kafshëve dhe veprimtaritë e rafinimit të vajit vegjetal

— Çdo veprimtari për ekstraktimin e vajit vegjetal nga farat dhe lëndë tjetër bimore, përpunimi i mbetjeve të thata për të prodhuar ushqim për kafshët, pastrimi i yndyrave dhe vajrave bimore që vijnë nga farat, lëndët bimore dhe/ose shtazore.

Lustrimi i makinave

— Çdo veprimtari lysterje industriale ose tregtare dhe aktivitetet e cgrasatimit/heqjes së yndyrës që lidhen me to që bëjnë:

— lysterjen e rimorkiove (përfshirë gjysëm rimorkiot) (kategoria O).

Veshje e telave/bobinave

— Çdo veprimtari lysterje/veshje e përçuesve metalik që përdoren për përdredhjen e telit në transformatorë dhe motorë, etj.

Ngopja/njomja e drurit

— Çdo veprimtari që fut një sasi prezervativi në një masë druri.

Laminimi i drurit dhe plastikës

— Çdo veprimtari që ngjit drurin me drurin dhe/ose plastikën për të prodhuar produkte të laminuara.

ANEKSI IIA

I. PRAGJET DHE KONTROLLET E SHKARKIMIT

	Veprimtaria (pragu i konsumit të tretësit në ton/për vit)	Pragu (pragu i konsumit të tretësit në ton/për vit)	Vlerat kufi të shkarkimit në mbetjet e gazta (mg C/Nm ³)	Vlerat e shkarkimit flurues (përqindja inputit të tretësve)		Vlerat kufi të shkarkimit total		Dispozita të veçanta
				E re	Ekzistuese	E re	Ekzistuese	
1	Proçesi i tharjes së shpejtë të bojës së stampimit/printimit me anë të ajrit të nxehtë (> 15)	15—25	100	30 (1)				(1) Mbetjet e tretësit në produktin e përfunduar nuk konsiderohen si pjesë e shkarkimeve fluruese.
		> 25	20	30 (1)				
2	Publikimi i materialeve me anë të procesit rotogravurë (> 25)		75	10	15			
3	Proçese të tjera rotogravurë, fleksografi, stampimi/printimi me makinë shtypi rotativë, laminim ose lustrim (> 15) Stampim/printim me makinë shtypi rotativë mbi tekstile/karton (> 30)	15—25	100	25				(1) Pragu për printimin me makinë shtypi rotative mbi tekstile dhe karton.
		> 25	100	20				
		> 30 (1)	100	20				
4	Pastrimi i sipërfaqes (1) (> 1)	1—5	20 (2)	15				(1) duke përdorur përbërësit e përcaktuar në paragrafin 13 dhe 15 të kreut V. (2) Kufiri i referohet masës së përbërësve në mg/Nm ³ , dhe jo karbonit total.
		> 5	20 (2)	10				

5	Pastrues të tjerë të sipërfaqes (> 2)	2—10	75 (1)	20 (1)				(1) Instalimet që i demonstrojnë AKM-së se përmbajtja mesatare e tretësit organik e të gjithë materialit pastrues të përdorur nuk kalon 30 % të peshës, përjashtohen nga zbatimi i këtyre vlerave.
		> 10	75 (1)	15 (1)				
6	Lyerja/veshja e mjeteve (< 15) dhe lustrimi i mjeteve	> 0,5	50 (1)	25				(1) Përputhshmëria me paragrafin 43 të Kreut IX demonstron bazuar në matjet mesatare prej 15 minutash.
7	Lyerja/veshja e bobinave (> 25)		50 (1)	5	10			(1) Për instalimet që përdorin teknikat të cilat lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, kufiri i shkarkimit është 150.
8	Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë metalin, plastikën, tekstin (5), pëlhurat, filmin dhe letrën (> 5)	5—15	100 (1) (4)	25 (4) ◀				(1) Vlera kufi e shkarkimit zbatohet mbi proceset e lyerjes/veshjes dhe tharjes që funksionojnë në kushte mbajtjeje. (2) Vlera kufi e shkarkimit të parë zbatohet në proceset e tharjes, e dyta në proceset e aplikimit të lyerjes/veshjes. (3) Për instalimet e veshjes/lyerjes së tekstileve të cilat
		> 15	50/75 (3) (4) (2)	20 (4)				

								<p>përdorin teknikat që lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, kufiri i shkarkimit të zbatuar në aplikimin e lyerjeve/veshjeve dhe proceset e tharjes të marra së bashku është 150.</p> <p>(4) Veprimtari veshje/lyerje të cilat nuk mund të zbatohen në kushte mbajtje (të tilla si ndërtimi i anijeve, lyerja e avionëve) mund të përjashtohen nga këto vlera, në përputhje me dispozitat e parashikuara, në shkronjën “a” të paragrafit 10 të Kreut V.</p> <p>(5) Printimi me makinë shtypi rotativë të tekstileve mbulohet nga veprimtaria numër 3.</p>
9	Veshja e telave të bobinave (> 5)					10 g/kg (1) 5 g/kg (2)		<p>(1) Zbatohet për instalimet kur diametri mesatar i telit është $\leq 0,1$ mm.</p> <p>(2) Zbatohet për të gjitha instalimet e tjera.</p>
10	Lyerja/veshja e sipërfaqeve të	15—25 > 25	100 (1) 50/75 (2)	25 20				<p>(1) Kufiri i shkarkimit zbatohet në</p>

	drurit (> 15)							<p>aplikimet e proçeseve të veshjes/lyerjes dhe tharjes që funksionojnë në kushte mbajtje.</p> <p>(2) Vlera e parë zbatohet në proçeset e tharjes, e dyta në proçeset e aplikimit të lyerjes/veshjes.</p>
11	Pastrimi kimik					20 g/kg (1) (2) (3)		<p>(1) Shprehur në masën e tretësit të lëshuar për kilogram të produktit të pastruar dhe të tharë.</p> <p>(2) Kufiri i shkarkimit në paragrafin 15 të Kreut V nuk zbatohet për këtë sektor.</p>
12	Ngopja/njomja e drurit (> 25)		100 (1)	45		11 kg/m ³		(1) Nuk zbatohet për ngopjen/njomjen me katran.
13	Veprimtari të lyerjes/veshjes së lëkurës (> 10)	10—25 > 25 > 10 (1)				85 g/m ² 75 g/m ² 150 g/m ²		<p>Kufijtë e shkarkimit të tretësit të lëshuar për m² të produktit të prodhuar shprehen në gram.</p> <p>(1) Për veprimtaritë e lyerjes/veshjes së lëkurës dhe veçanërisht mallrat e lëkurës që përdoren si mallra të vogla për konsumatorin të tilla si çanta, rripa, portofola, etj.</p>
14	Prodhimi i					25 g për palë		Vlerat kufi të

	këpucëve (> 5)							shkarkimit total shprehen në gram tretës të shkarkuar për çdo palë këpucë të prodhuara.
15	Laminimi i drurit dhe plastikës (> 5)					30 g/m ²		
16	Veshje me adeviv/ngjitje (> 5)	5—15 > 15	50 (1) 50 (1)	25 20				(1) Në qoftë se janë përdorur teknika që lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, vlera e shkarkimit kufi në mbetjet e gazta do të jetë 150.
17	Prodhimi i përzierjeve veshëse, llakrave, bojrave të printimit dhe ngjitësve (> 100)	100—1 000 > 1 000	150 150	5 3		5 % e inputit të tretësit 3 % e inputit të tretësit		Vlera e shkarkimit të avullueshëm nuk përfshin tretësin e shitur si pjesë të një përzierje veshëse në një enë të vulosur.
18	Shndërrimi i gomës (> 15)		20 (1)	25 (2)		25 % e inputit të tretësit		(1) Në qoftë se janë përdorur teknika që lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, vlera e shkarkimit kufi në mbetjet e gazta do të jetë 150. (2) Vlerat e shkarkimit flurues nuk përfshin tretësin e shitur si pjesë e një produkti ose përzierje në një enë të vulosur.
19	Ekstraktimi i vajit vegjetal dhe yndyrës së kafshëve, si dhe veprimtaritë e					Yndyrë shtazore: 1,5 kg/ton Kastor: 3 kg/ton		(1) Vlerat kufi të shkarkimit total për instalimet e përpunimit të grupeve të caktuara

	rafinimit të vajit vegjetal (> 10)					bërsi rrushi: 1 kg/ton Fara luledielli: 1 kg/ton Kokrrat e sojës (shtypje normale): 0,8 kg/ton Kokrrat e sojës (fletë të bardha): 1,2 kg/ton Fara të tjera dhe lëndë të tjera bimore: 3 kg/ton (1) 1,5 kg/ton (2) 4 kg/ton (3)	të farave dhe lëndëve të tjera bimore vendosen nga AKM rast pas rasti, duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme. (2) zbatohet për të gjitha proçeset e fraksionimit perjashtuar heqjen e ngjitësve nga vaji. (3) zbatohet për heqjen e ngjitësve.
20	Prodhimi i produkteve farmaceutike (> 50)	20 (1)	5 (2)	15 (2)	5 % e inputit të tretësit	15 % e inputit të tretësit	(1) Në qoftë se përdoren teknika që lejojnë ripërdorimin e tretësve të rigjeneruar, vlera kufi e shkarkimit në mbetjet e gazta duhet të jetë 150. (2) Vlera kufi e shkarkimit flurues nuk përfshin tretësin e shitur si pjesë të produkteve ose përzierjeve në një enë të vulosur.

II. INDUSTRIA E VESHJES SË AUTOMJETEVE

Vlerat kufi të shkarkimit total shprehen në gram tretës të shkarkuar në lidhje me sipërfaqen e produktit në metra katrorë dhe në kilogramë tretës të shkarkuar në lidhje me trupin e makinës.

Sipërfaqja e çdo produkti të trajtuar në tabelën e mëposhtme përcaktohet si më poshtë:

— sipërfaqja e llogaritur nga sipërfaqja totale me veshje elektroforetike dhe sipërfaqja e çdo pjese, që mund të shtohet në fazat e mëpasme të procesit të lyerjes, të lyera me të njëjtën veshje si ajo e përdorur për produktin në fjalë, ose sipërfaqja totale e produktit të lyer/veshur në atë instalim.

Sipërfaqja e veshjes elektroforetike llogaritet duke përdorur formulën:

$$2 \times \text{pesha totale e syprinës së produktit}$$

Trashësia mesatare e fletës së metalit x densiteti i fletës së metalit

Kjo metodë duhet të zbatohet edhe për pjesë të tjera të veshura të ndërtuara prej fletësh metali. Për të llogaritur sipërfaqen e pjesëve të tjera të shtuara ose sipërfaqen totale të veshur në atë instalim përdoret projektimi me kompjuter ose metoda të tjera ekuivalente.

Vlera kufi e shkarkimit total në tabelën më poshtë i referohet të gjithë fazave të procesit që kryhen në të njëjtin instalim që nga veshja elektroforetike apo çdo lloj tjetër procesi veshje, deri në ilustron përfundimtare me dyllë deri në shtresën e sipërme, dhe tretësit që përdoret për pastrimin e pajisjeve të procesit, përfshirë kabinat e sprucimit dhe pajisje të tjera të palëvizëshme, gjatë dhe jashtë kohës së prodhimit.

Vlera kufi e shkarkimit total shprehet si shumë e masës së përbërësve organikë për m² të sipërfaqes totale të produktit të veshur dhe shumës së masës të përbërësve organikë për një trup automjeti.

Veprimtaria (pragu i konsumit të tretësit në ton/vit)	Pragu i prodhimit (referuar prodhimit vjetor të artikujve që ju aplikohet veshje)	Vlera kufi e shkarkimit total	
		E re	Ekzistuese
Veshja e makinave të reja (> 15)	> 5 000	45 g/m ² ose 1,3 kg/për trup + 33 g/m ²	60 g/m ² ose 1,9 kg/për trup + 41 g/m ²
	≤ 5 000 shasi integrale ose	90 g/m ² ose	90 g/m ² ose 1,5 kg/për trup + 70 g/m ²
	> 3 500 shasi e ndërtuar prej pjesësh	1,5 kg/për trup + 70 g/m ²	
		Kufiri i shkarkimit total (g/m ²)	
Veshja e kabinave të kamionëve të rinj (> 15)	≤ 5 000	65	85
	> 5 000	55	75
Veshja e furgonëve	≤ 2 500	90	120

dhe kamionëve të rinj (> 15)	> 2 500	70	90
Lyerja e autobusëve të rinj (> 15)	≤ 2 000	210	290
	> 2 000	150	225

Instalimet ku realizohet veshja e automjeteve, të cilat bien nën pragjet e konsumit të tretësit të dhëna në tabelën më sipër përmbushin kërkesat për sektorin e lustrimit të automjeteve të përcaktuara në Aneksin IIA.

ANEKSI II B

SKEMA E PAKËSIMIT TË SHKARKIMEVE

1. Parimet

Qëllimi i skemës së pakësimit është t'i krijojë operatorit mundësinë të arrijë me mjete të tjera pakësimin e shkarkimeve, ekuivalente me ato që do të arriheshin në qoftë se do të zbatoheshin vlerat kufi të shkarkimit. Për këtë qëllim operatori mund të përdorë cilëndo skemë pakësimi, të projektuar specifikisht për instalimin e tij, me kusht që në fund të arrihet një pakësim ekuivalent shkarkimi. Progresi i bërë për arritjen e këtij pakësimi të shkarkimeve dhe eksperiencia e fituar nga zbatimi i skemës përkatëse do të pasqyrohen në raportin që referohet në paragrafin 49, të Kreut XI të këtij vendimi.

2. Praktika

Në rastet e aplikimit të veshjeve, llaqeve, ngjitësve ose bojës mund të përdoret skema e mëposhtme. Kur metoda e mëposhtme është e papërshtatshme AKM mund të lejojë operatorin të përdorë një skemë alternative përjashtimi e cila përmbush parimet e përshkruara këtu. Projektimi i skemës merr parasysh faktet e mëposhtme:

- a. Aty ku nuk janë gjetur akoma produkte zëvendësues që përmbajnë pak ose aspak tretës, operatorit i shtyhet afati për zbatimin e planeve të tij të pakësimit të shkarkimeve;
- b. paragrafi referencë për pakësimet e shkarkimeve duhet t'i korespondojë sa më shumë të jetë e mundur shkarkimeve që do të rezultojnë, në qoftë se nuk do të merreshin masa për pakësimin e tyre.

Skema e mëposhtme funksionon për instalimet ku për të përcaktuar paragrafin referencë për pakësimin e shkarkimeve mund të supozohet dhe përdoret përmbajtja konstante e trupave të ngurtë të produktit:

- (i) Operatori paraqet në AKM planin e pakësimit të shkarkimit, i cili përfshin në veçanti pakësimin e përmbajtjes mesatare të tretësit në inputin total dhe/ose rritje të efikasitetit në përdorimin e materialit të ngurtë për arritjen e pakësimit të shkarkimeve totale nga instalimi në një përqindje të dhënë të shkarkimeve vjetore referencë, të quajtur shkarkimi i synuar. Kjo bëhet në periudhat kohore të mëposhtme:

Periudha kohore		Maksimumi i lejuar i shkarkimeve totale vjetore
Instalimet e reja	Instalimet ekzistuese	
Nga 31.10.2017	Nga 31.10.2022	shkarkimi i synuar $\times 1,5$
Nga 31.10.2020	Nga 31.10.2024	shkarkimi i synuar

- (ii) Shkarkimi vjetor reference llogaritet si më poshtë:

- a. Përcaktohet masa totale e lëndës së ngurtë në sasinë e veshjes dhe/ose bojës, llakut ose ngjitësit të konsumuar në një vit. Lëndë e ngurtë janë të gjitha materialet në veshje, bojë, llak dhe ngjitës që ngurtësohet kur uji ose përbërësit organikë të avullueshëm avullojnë.
- b. Shkarkimet vjetore referencë llogariten duke shumëzuar sasinë e përcaktuar në pikën “a” më lart me faktorin e duhur të listuar në tabelën e mëposhtme. AKM mund t’i ndryshojë këta faktorë për secilin instalim për të reflektuar rritjen efiçencës së përdorimit të lëndës së ngurtë të evidentuar me dokumentave.

Veprimtaria	Faktori shumëzues që duhet përdorur në pikën (ii)(b) më lart
Printimi Rotogravure; printimi flexografik; laminimi si pjesë e veprimtarisë printuese; lustrimi si pjesë e veprimtarisë printuese; veshja/lyerja e drurit; veshja/lyerja e tekstileve, pëlhurave, filmit ose letrës; veshja me adhezive	4
Lyerja/veshja e bobinave, lustrimi i automjeteve	3
Veshja/lyerja e jashtme e ushqimeve, veshja/lyerja e paisjeve aerospaciale	2,33
Veshje/lyerje të tjera dhe printim me rotary screen printing	1,5

- c. Shkarkimi i synuar është sa shkarkimi vjetor referencë i shumëzuar me një përqindje të barabartë me:
 - (vlerën e shkarkimit flurues + 15), për instalimet që bien midis pikës 6 të Aneksit IIA dhe pragut më të ulët në krahasimin midis pikës 8 dhe 10 po aty,
 - (vlerën e shkarkimit flurues + 5) për të gjitha instalimet e tjera.
- d. Përputhshmëria arrihet në qoftë se shkarkimi i tretësit ekzistues të përcaktuar nga plani i menaxhimit të tretësit është më pak ose i barabartë me shkarkimin e synuar.

ANEKSI III
PLANI I MENAXHIMIT TË TRETËSVE

1. Hyrje

Ky aneks jep udhëzime për hartimin e planit të menaxhimit të tretësve. Ai jep parimet që duhen zbatuar (paragrafi 2 më poshtë), kuadrin për bilancin e masës (paragrafi 3 më poshtë) dhe treguesin e kërkesave për verifikimin e përputhshmërisë (paragrafi 4 më poshtë).

2. Parimet

Plani i menaxhimit të tretësve shërben për qëllimet e mëposhtme:

- i. verifikimin e përputhshmërisë sipas përcaktimit të paragrafit 39 të Kreut IX;
- ii. identifikimin e mundësive për pakësime të ardhshme;
- iii. sigurimin për publikun të informacionit mbi konsumin dhe shkarkimet e tretësve dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e këtij vendimi.

3. Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme japin bazat për kryerjen e bilancit të masës.

Inputi i tretësve organikë (I):

I1 Sasia e tretësve organikë ose sasi të tyre në preparatet e blera të cilat janë përdorur si input në një proces të caktuar në harkun kohor për të cilin llogaritet bilanci i masës.

I2 Sasia e tretësve organikë ose sasia e tyre në preparatet e rikuperuar/rigjeneruar dhe ripërdorur në inputin e tretësve në këtë proces. (Tretësi i ricikluar llogaritet sa herë që përdoret për të kryer veprimtarinë.)

Produktet e tretësve organikë (O):

O1 Shkarkimet në mbetjet e gazta.

O2 Tretësit organikë që kanë humbur në ujë. Në qoftë se është e përshtatshme, kur llogaritet O5, merret parasysh trajtimi i ujërave të ndotur.

O3 Sasia e tretësve organikë që mbeten si ndotje ose mbeturina në produktet që rezultojnë nga procesi.

O4 Shkarkimet e pakapura në ajër të tretësve organikë. Kjo përfshin ventilimin e përgjithshëm të dhomave, ku ajri çlirohet në mjedisin e jashtëm nëpërmjet dritareve, dyerve, ventilatorëve dhe të carave të ngjashme.

O5 Tretësit organikë dhe/ose përbërësit organikë që kanë humbur gjatë reaksioneve kimike ose fizike (përfshirë për shembull ato që janë shkatërruar psh. nga incinerimi, në mbetjet e tjera të gazta, gjatë trajtime të ujërave të ndotur apo ato që janë kapur psh

përmes adsorbimit për sa kohë ato nuk llogariten sipas O6, O7 ose O8).

O6 Tretësit organikë që ndodhen në mbetjet e grumbulluara.

O7 Tretësit organikë ose tretësit organikë që gjenden në preparatet që shiten ose synohet të shiten në treg si produkte.

O8 Tretësit organikë që gjenden në preparatet e rikuperuara/rigjeneruara për ripërdorim por jo si input në proces, për sa kohë që nuk llogariten sipas O7.

O9 Tretësit organikë të shkarkuar në rrugë të tjera.

4. Udhëzim për përdorimin e planit të menaxhimit të tretësve për verifikimin e përputhshmërisë

Përdorimi i planit të menaxhimit të tretësit përcaktohet nga kërkesa e veçantë që duhet verifikuar, si më poshtë:

i. Verifikimi i përputhshmërisë me opcionin e pakësimit të shkakrimeve që jepet në Aneksin IIB, me vlerën kufi të shkarkimit total të shprehur si shkarkim i tretësve për njësi produkti ose siç thuhet ndryshe në Aneksin IIA.

a. Për të gjitha veprimtaritë që përdorin skemën e pakësimit të shkarkimeve, për të përcaktuar konsumin (C) plani i menaxhimit duhet të hartohet çdo vit. Konsumi mund të llogaritet sipas ekuacionit: $C = I1 - O8$

Gjithashtu, për të nxjerrë shkarkimin vjetor referencë dhe shkarkimin e synuar për çdo vit, paralelisht me sa më lart duhet të përcaktohet lënda e ngurtë që përdoret në veshje/lyerje.

b. Për vlerësimin e përputhshmërisë me vlerën kufi të shkarkimit total të shprehur në shkarkimet e tretësve për njësi produkti ose siç shprehet ndryshe në Aneksin IIA, plani i menaxhimit të tretësve për përcaktimin e shkarkimeve (E) duhet të bëhet çdo vit. Shkarkimet mund të llogariten sipas ekuacionit: $E=F+O1$

Ku F është shkarkim fluruese sipas përcaktimit në seksionin (ii)(a). Shifra e shkarkimit duhet më pas të pjestohet nga parametri i produktit përkatës.

c. Për vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat e pikës “b” (ii) të paragrafit 12 të Kreut V, për të përcaktuar shkarkimet totale nga të gjitha veprimtaritë në fjalë plani i menaxhimit të tretësve duhet të hartohet çdo vit. Kjo shifër duhet më pas të krahasohet me shkarkimet totale që mund të rezultonin në qoftë se kërkesat e Aneksit II do të ishin plotësuar për secilën veprimtari më vete.

ii. Përcaktimi i shkarkimeve fluruese për krahasimin me vlerat e shkarkimeve fluruese në Aneksin IIA:

a. Metodologjia

Shkarkimet fluruese mund të llogaritet sipas ekuacionit:

$$F = I1 - O1 - O5 - O6 - O7 - O8$$

Ose

$$F = O2 + O3 + O4 + O9$$

Kjo sasi mund të përcaktohet nga matja e drejtpërdrejtë e sasive. Një llogaritje e ngjashme mund të bëhet me mjete të tjera, për shembull duke përdorur eficientë e kapjes së këtyre shkarkimeve nga ky proces.

Vlera e shkarkimeve fluruese është shprehur si proporcion i inputit, që mund të llogaritet sipas ekuacionit:

$$I = I1 + I2$$

b. Shpeshtësia

Përcaktimi i shkarkimeve fluruese mund të bëhet nga një grup matjesh të shkurtra por gjithpërfshirëse dhe nuk ka nevojë të bëhet përsëri derisa pajisja të modifikohet.

ANEKSI IV

KRITERET PËR VLERËSIMIN E PLANEVE KOMBËTARE

A. Kriteret për demonstrimin e njohjes së detajuar të shkarkimeve aktuale

1. Plani kombëtar demonstroi se ministria njih me hollësi shkarkimet aktuale.

Evidenca minimale të pranueshme

Ministria paraqet një deklaratë të shkruar e cila:

- a. identifikon veprimtarinë ose veprimtaritë për të cilat zbatohet plani; klasifikon sipas një sistemi të dokumentuar; identifikon numrin e instalimeve të prekura nga plani;
- b. vlerëson shkarkimet totale nga instalimet e prekura nga plani;
- c. identifikon burimin e çdo faktori shkarkimi dhe statistikën e veprimtarive të përdorura për vlerësimin e shkarkimeve; dhe
- d. përshkruan metodat e përdorura për të gjetur faktorët e shkarkimit.

B. Kriteret për justifikimin e përdorimit të planit kombëtar

2. Hartimi i Planit kombëtar është i nevojshëm për adoptimin e një qasje të ndryshme nga sa jepet në dispozitat e paragrafit 9 dhe 10 të kreut V dhe Aneksit II të këtij vendimi.

Evidenca minimale të pranueshme

Ministria duhet të paraqesë një deklaratë të shkruar ku shpjegon përfitimet nga përdorimi i planit kombëtar në krahasim me përdorimin e dispozitave të paragrafit 9 dhe 10 të Kreut V dhe Aneksit II të këtij vendimi.

C. Kriteret për demonstrimin e përputhshmërisë së planit kombëtar me legjislacionin, politikën dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi

3. Plani kombëtar duhet të konfirmojë përputhshmërinë me politikën, legjislacionin e posaçëm në këtë fushë, si dhe me marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe në të cilat Shqipëria është palë.

Evidenca minimale të pranueshme

Ministria paraqet një deklaratë të shkruar me evidencë mbështetëse, sipas të cilave ajo ka konsideruar përputhshmërinë e planit kombëtar me legjislacionin e posaçëm.

D. Kriteria të tjera më të hollësishme kur plani kombëtar përmbush kriteret e përcaktuara në pikat “A”, “B” dhe “C”, merren parasysh.

Evidencat minimale të pranueshme detajohen sipas të gjitha kriterëve 4 deri 26 të këtij aneksi.

Kriteret për demonstrimin e përputhshmërisë me kërkesat specifike të parashikuara në Kreun VI të këtij Vendimi.

4. Plani kombëtar zbatohet vetëm për instalimet ekzistuese. (Paragrafi 21 i Kreut VI)
5. Plani kombëtar nuk zbatohet për veprimtarinë e 4-të dhe të 11-të të përcaktuar në Aneksin II(A). (paragrafi 23 të Kreut VI).
6. Plani kombëtar nuk përjashton nga objekti i këtij vendimi asnjë nga veprimtaritë e listuara në Aneksin 1 (paragrafi 23 të Kreut VI).
7. Plani kombëtar nuk përjashton instalimet ekzistuese nga kërkesat për veprimtaritë e Tipit A të parashikuara në legjislacionin e posaçëm për lejet e mjedisit (paragraph 21 of chapter VI).
8. Plani kombëtar përfshin listën e masave të marra ose që do të merren për të siguruar arritjen e qëllimit të përcaktuar në paragrafin 21 të Kreut VI (paragrafi 28 të kreut VI).
9. Plani kombëtar jep detaje për mekanizmin e monitorimit të planit të propozuar (paragrafi 28 i kreut VI).
10. Plani kombëtar vendos objektiva detyruese të ndërmjetme kundrejt të cilave mund të matet progresi në drejtim të qëllimit të përcaktuar në paragrafin 21 të kreut VI (paragrafit 28 të Kreut VI).
11. Plani kombëtar identifikon veprimtarinë ose veprimtaritë të cilave i referohet plani (paragrafi 28 i Kreut VI).
12. Plani kombëtar përcakton pakësimin e shkarkimeve që duhet të arrihet nga këto veprimtari, që korespondon me pakësimin që mund të ishte arritur duke zbatuar vlerat kufi të shkarkimit dhe/ose vlerat e shkarkimeve fluruese sipas paragrafit 9 dhe 10 të Kreut V dhe Aneksit II të këtij vendimi (paragrafi 28 i Kreut VI).
13. Plani kombëtar liston numrin e instalimeve që mbulohen nga plani, shkarkimet totale të tyre dhe shkarkimin total të secilës veprimtari (paragrafi 28 i kreut VI).
14. Plani kombëtar përshkruan gamën e instrumentave përmes të cilave arrihen kërkesat e tij, evidencat se këto instrumenta do të jenë të detyrueshëm dhe detaje mbi mjetet me të cilat do të demonstron përpunshmëria me planin (paragraph 28 of chapter VI).

Kriteret që demonstron përpunshmërinë me dispozita të tjera të këtij vendimi

15. Plani kombëtar identifikon masat e nevojshme, që janë marrë ose do të merren për të siguruar që instalimet e mbuluara nga plani përputhen me Kreun V (me përjashtim të rasteve, kur lejohet në plan, paragrafi 9 dhe/ose 10), Kreu VIII dhe IX dhe çdo kërkesë e planit jo më vonë se 31 Tetori 2022 (pika “a” e paragrafit 5 të kreut IV).
16. Plani kombëtar identifikon masat e nevojshme që janë marrë ose do të merren për të siguruar që instalimet e mbuluara prej tij do të jenë regjistruar ose lejuar jo më vonë se 31 Tetor 2022 (pika “b” e paragrafit 5 e kreut IV).
17. Plani kombëtar identifikon masat e nevojshme që janë marrë ose do të merren për të siguruar që instalimet e mbuluara nga plani do të plotësojnë kërkesat për monitorimin të përcaktuara në Kreun VIII.
18. Plani kombëtar identifikon masat e nevojshme që janë marrë ose do të merren për të siguruar që instalimet që mbulohen nga plani do të demonstron përpunshmëri me vlerat kufi të shkarkimit dhe/ose vlerat e shkarkimeve fluruese të përcaktuara nga plani kombëtar në përputhje me Kreun IX.
19. Plani kombëtar identifikon masat e nevojshme që janë marrë ose do të merren për të siguruar që instalimet e mbuluara nga plani do të përputhen me Kreun X, në qoftë se është konstatuar shkelje e kërkesave të këtij Vendimi ose të planit.

20. Plani kombëtar përshkruan se si raportet e hartuara në përputhje me Kreun XI përfshijnë të dhëna përfaqësuese të mjaftueshme për të demonstruar përmbushjen e kërkesave të Kreut VI të këtij vendimi (paragrafi 49 i Kreut XI).
21. Plani kombëtar përshkruan masat e nevojshme që janë marrë ose do të merren për të siguruar të drejtën e publikut për të marrë informacion në lidhje me instalimet e mbuluara nga plani në përputhje me Kreun XII.

Kriteret që demonstrojnë se plani do të sjellë një pakësim ekuivalent të shkarkimeve vjetore

22. Plani kombëtar përcakton sasinë e shkarkimeve vjetore aktuale nga instalimet e mbuluara nga plani.
23. Plani kombëtar përcakton në mënyrë sasiore pakësimin e shkarkimeve vjetore nga instalimet e mbuluara prej tij që mund të ishin arritur duke zbatuar vlerat kufi të shkarkimit për mbetjet e gazta dhe/ose vlerat e shkarkimeve fluruese sipas paragrafit 9 dhe 10 të Kreut V dhe Aneksit II të këtij vendimi.
24. Plani kombëtar përcakton në mënyrë sasiore pakësimin e shkarkimeve vjetore nga instalimet e mbuluara prej tij që do të arrihen si rezultat i zbatimit të tij.
25. Plani kombëtar demonstroi se pakësimi sipas kriterit të përcaktuar në paragrafin 24 të këtij aneksi do të jetë të paktën aq i madh sa pakësimi sipas kriterit të përcaktuar në paragrafin 23 të këtij aneksi.

Kriteret për vlerësimin e mjeteve, përputhshmëria e të cilëve me planin do të demonstrohet sipas kriterit 14 të këtij aneksi dhe paragrafit 28 të Kreut VI të këtij vendimi.

26. Plani kombëtar tregon se mjetet me të cilat demonstrohet përputhshmëria me planin do të jenë mjaftueshëmrisht të fortë për të mundur verifikimin e përputhshmërisë nga një palë e tretë.

Evidenca minimale të pranueshme për kriteret 4 deri 26 të këtij aneksi

Janë katër fusha kryesore për të cilat duhet të sigurohen evidenca, të përmbledhura si më poshtë:

- (i) Ministria paraqet listën e instalimeve që përcakton për t'u mbuluar nga plani kombëtar, të detajuar të paktën në nivel veprimtarie (sipas përcaktimit në Aneksin II(A)).
- (ii) Ministria paraqet detaje se si plani kombëtar zbatohet nga AKM, përfshirë:
 - mënyrën se si vendosen dhe monitorohen afatet kohore nga AKM;
 - mënyrën se si AKM do të mbaje të dhënat për çdo instalim të mbuluar nga plani kombëtar;
 - mënyrën se si në një nivel instalimi këto evidenca do të përmbajnë detaje të veprimtarive të mbuluara; të masave të marra, të orëve gjatë të cilave pajisja ka funksionuar; të vlerave kufi të shkarkimit dhe/ose të vlerave të shkarkimeve fluruese dhe/ose objektivat e ndërmjetme të detyrueshme për t'u arritur; mjetet e monitorimit/demonstrimit të përputhshmërisë me vlerat kufi të shkarkimit dhe vlerat e shkarkimeve fluruese;

- metodat e monitorimit, raportimit dhe demonstrimit të përputhshmërisë me planin.
Ministria duhet të përdorë ose qasjen e bilancit të masës sipas aneksit III ose procedura për matjen e përqendrimit të masës dhe të volumit të prurjes, në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare apo ndërkombëtare. Në qoftë Ministria propozon mjete të tjera demonstrimi, plani kombëtar duhet të sigurojë evidencat përkatëse me të njëjtën korrektesë.
- (iii) Ministria paraqet inventarin e shkarkimeve për të gjitha instalimet e mbuluara nga plani kombëtar. Ministria siguron evidenca në formën e të dhënave përfaqësuese dhe metodologjive të dokumentuara për të mundësuar verifikimin e pavarur të shkarkimeve të raportuara. Ky inventar duhet të jetë i përshtatshëm për të demonstruar ekuivalencën me Vendimin dhe Ministria duhet të sigurojë llogaritjet përfaqësuese të pakësimeve në shkarkimet vjetore të raportuara sipas kriterit 23 dhe 24 që mundëson verifikimin e pavarur të metodologjive të llogaritjes.
- (iv) Ministria përshkruan se si plani kombëtar, objektivat e tij dhe progresi i cdo instalimi në drejtim të këtyre objektivave do të bëhet i disponueshëm për publikun. Mund të ketë raste kur disa informacione mund të konsiderohet si konfidenciale dhe për këtë arsye të mos jenë të hapura për publikun. Shembujt përfshijnë:
 - identitetin e instalimeve me natyrë ushtarake;
 - hollësira në lidhje me disa instalime kur për treguesit e vëllimit të prodhimit mund të ketë ndjeshmëri të lartë tregtare, të tillë si inputi i tretësve, orët e funksionimit dhe vëllimi i prurjeve.